



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 7364 Prot.

Tiranë, më 06/10 /2014

UDHËZIM

Nr. 37, Datë 06/10 /2014

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 33, DATË 19.09.2014 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PUBLIK E PRIVAT NË VITIN AKADEMIK 2014-2015 TË STUDENTËVE QË TRANSFEROJNË STUDIMET NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË TË CILËVE U ËSHTË HEQUR LICENCA"

Në mbështetje të nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit nr. 539, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë",

UDHËZOJ:

- I. Udhëzimi nr. 33 datë 19.09.2014 "Për procedurat e pranimit, në institucionet e arsimit të lartë publik e privat në vitin akademik 2014-2015 të studentëve që transferojnë studimet nga institucionet private të arsimit të lartë të cilëve u është hequr licenca" ndryshojë si më poshtë:
 1. Pika 7 e Kreut IV të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"Nga data 29 shtator deri në orën 12:00 të datës 13 tetor 2014 nga ana e studentëve kryhet aplikimi me dokumente origjinalë sipas (pikës 2 të këtij udhëzimi), për programet e studimit të ofruara nga Fakulteti përkatës, sipas listave të programeve të studimit të ekuivalentuara. Brenda datës 13 tetor 2014 IAL-të publike dërgojnë në MAS listat e aplikantëve duke specifikuar kandidatët të cilët pas shqyrtimit të dosjeve, rezultojnë me dosje të rregullta, të shoqëruar me planin e veprimeve për ekuivalentimin e studimeve të kryera, si dhe i shpallin ato publikisht në vende të dukshme, faqet web të IAL-së dhe media elektronike dhe të shkruar. "
 2. Pika 8 e Kreut IV të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"Komisionet e vlerësimit dhe të ekuivalentimit të ngritur pranë IAL-ve publike kryejnë vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të kandidatëve që rezultojnë të rregullta me qëllim ekuivalentimin e rezultateve individuale të secilit prej studentëve ndjekjes së programeve

përkatës të studimit në IAL-të private të cilëve iu është hequr licenca, deri në orën 12:00 të datës 15 tetor 2014. Ekuivalentimi individual bëhet duke u bazuar në ekuivalentimin paraprak për çdo program studimi. "

3. Pika 10 e Kreut IV të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Dekanatet e Fakulteteve bazuar në vendimin e komisionit të vlerësimit dhe ekuivalentimit, shpallin, brenda datës 15 tetor 2014, të dhënat për çdo kandidat, kreditet e ekuivalentuara, detyrimet dhe lëndët e pashlyera si dhe vitin në të cilin transferohet."
 4. Pika 11 e Kreut IV të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Në periudhën nga data 15 tetor 2014 deri në datën 20 tetor 2014 bëhet regjistrimi i studentëve pranë sekretarive mësimore të Fakultetit përkatës dhe paguhet tarifa përkatëse. Shuma e derdhur nuk kthehet edhe në rastet kur kandidati largohet nga programi i studimit."
 5. Pika 1 e kreut VI të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Kandidatët aplikojnë pranë IAL-ve private nga data 25 shtator deri në datën 17 tetor 2014."
 6. Pika 4 e kreut VI të Udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:
"Në IAL-të private aplikantët regjistrohen përfundimisht brenda datës 20 tetor 2014."
- II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

